



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.11.2021

Lënda: Informacion mbi autorë të veprave penale me tendenca kriminale abuzim seksual, dhunë dhe vrasje.

Ju bëjmë me dije se, Policia e Shtetit, në zbatim të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në përmbushje të misionit të saj për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike dhe jetës e shëndetit të qytetarëve ka punuar për parandalimin dhe zbulimin e krimeve, si dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të tyre.

Me gjithë masat e marra për parandalimin, hetimin e veprave penale kundër jetës dhe shëndetit, si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve hasen një sërë vështirësish, përse i përket masave që merren pas ndalimit/arrestimit të autorëve të krimeve, pasi konstatojmë që në disa raste caktohen masa të sigurisë dhe dënime “të buta” penale, ndaj autorëve, nga ana e institucionit të Prokurorisë dhe Gjykatës.

Në disa raste, autorë të krimeve të rënda, të dyshuar për vrasje, abuzime seksuale, dhunë në familje, procedohen me masa sigurie “arrest në shtëpi”, “gjendje të lirë” ose pas gjykimit përfitojnë ulje të dënimeve penale, deri në lirim të tyre. Kjo kategori autorësh përbëjnë burim për kryerjen e krimeve edhe më të rënda.

Më poshtë, Ju lutem gjeni njëinformacion mbi rastet, kur është konstatuar se, autorë të krimeve të ndryshme kundër jetës dhe shëndetit kanë përfituar dënime të “buta” apo janë liruar nga Institucionet e Vuajtjes së Dënimeve Penale para përfundimit të afatit, gjatë viteve të fundit:

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë:

1. Më datë 25.02.2015, është arrestuar nga forcat policore të Komisarariatit të Policisë Përmet, shtetasi Tori (Hektor) Xheçuka, për ‘Kundërshtim të punonjësit të Policisë’ parashikuar nga neni 236 Kodit Penal. Më datë 05.11.2018, është bërë ndalimi i shtetasit Tori (Hektor) Xheçuka, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, “Vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë dhe ‘Armbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 78,78-25,278/1 të Kodit Penal. Me vendim nr.2149 Akti, datë 07.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dhënë masa e sigurimit ‘Arrest me burg”, për shtetasin Tori Xheçuka, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, “Vrasje me paramendim”, mbetur në tentativë dhe “Armbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 78,78-25,278/1 të Kodit Penal. Ky person dyshohet si autor i kryerjes së disa ngjarjeve të rënda kriminale.

2. Shtetasi Gjergj Cukali, në vitin 1994, është dënuar me 5 muaj burg, pasi ka vjedhur makinën e shtetasit, Anton Kolaj, në vitin 1996 është dënuar me 3 muaj burg, pasi ka vjedhur pjesë të motoçikletës së shtetasit Ilir Beqja, në vitin 1998 dhe vitin 1999, është dënuar dy herë për armëmbajtje pa leje.

Për këtë shtetas ka disa vendime të Gjykatave e konkretisht: Me Vendim 450 dhe nr. Akti 548, datë 17.06.1996, të Gjykatës Rrethit Tiranë, është dënuar me tre muaj burgim për veprën penale të ‘Vjedhjes në bashkëpunim’, parashikuar nga nenet 134,25,51,48/ç të Kodit Penal. Me Vendim nr. 678 dhe nr.831 të Rregjistrat Themeltar, të Gjykatës Rrethit Tiranë, është dënuar me pesë muaj burgim për veprën penale të “Vjedhje në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 134-25 të Kodit Penal. Me vendim nr.9 datë 24.01.2000, të Gjykatës së Rrethit Lushnje është caktuar si masë sigurimi “Arrest në burg”, në mungesë për shtetasit Gjergj Cukali dhe Tefik Myftari. Me Vendim nr.794 dhe nr.1015 Akti, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes në bashkëpunim” parashikuar nga neni 134-25 të Kodit Penal, është deklaruar i pafajshëm, për veprën penale të përkrahjes pas kryerjes së krimit, parashikuar nga neni 302 të Kodit Penal. Me datë 22.03.2002, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë “Vendim për lirim të menjëhershëm të të ndaluarit Gjergj Cukali”.

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka ngritur akuzë ndaj grupit kriminal të rrugës së “Myslym Shyrit”, ndaj shtetasve Gjergj Cukali, Durim Gjurzi, Ilir Kodumi, Ledio Lito, Florian Metalla, Eduart Skuka, në lidhje me pengëmarrjen e shtetasit Fatjon Demirlika, vrasjen e shtetasit Endri Shimës dhe Edmond Çullhajt në Londër.

Me Vendim nr.28 datë 27.06.2006 dhe nr.36/113 akti datë 20.06.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit Gjergj Cukali për veprat penale të ‘Rrëmbimit dhe mbajtjes peng të personit’ dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 109/3-25 dhe 278/2 të Kodit Penal, i cili është dënuar me 22 (njëzet e dy) vjet burgim dhe dënimin me 14 vjet e 8 muaj burgim. Me vendim nr. 59 datë 24.11.2006, përfundimisht është dënuar me 10 vjet burgim. Me Vendim nr.73, datë 24.05.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Vendimi nr.1820/1 datë 02.02.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur zëvendësimi i masës së sigurimit personal nga ajo e “Arrest me burg”, në atë të ‘Arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike’.

Ky person është autor i vrasjes së shtetasit Arben Demir Bilali, ngjarje e ndodhur më datë 30.01.2019. Më datë 31.05.2019, pas hetimeve disa mujore është arrestuar shtetasi Gjergj Pjerin Cukali, i dyshuar si autor i vrasjes së shtetasit Arben Bilali, ngjarje e ndodhur në datë 30.01.2019, në rrugën ‘Isuf Balta’ Tiranë, për veprën penale “Vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim, “Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 78-25 dhe 278/1 të K.Penal. Gjykata e Apelit Tiranë me vendim të datës 04.09.2019, ka vendosur ndryshimin e masës së sigurimit nga “Arrest me burg”, në “Detyrim paraqitje”.

Me Vendim nr.28, datë 27.06.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në Gjykim të Çështjes Penale nr.36/113 Akti, ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit Gjergj Pjerin Cukali, për kryerjen e veprës penale “Rrëmbim ose mbajtje peng të personit”, parashikuar nga neni 109/1-25 K.Penal, dënuar me 10 vite burgim.

Me datë 19.08.2012, nga ana e Specialistëve të Komisarariatit të Policisë nr.2, është bërë arrestimi i shtetasit Gjergj Pjerin Cukali, për veprën penale të ‘Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake’, neni 278/1 K.Penal.

Me datë 11.07.2016, u bë ndalimi i shtetasit Gjergj Pjerin Cukali, pasi me datë 11.07.2016 Prokurori i Çështjes z.Julian Zonja, ka nxjerre urdhër për ndalimin e këtij shtetasi si i dyshuar për

veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh”, kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 283/2 K.Penal.

Me vendim nr.73, datë 24.05.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur, ndryshimi i vendimit nr.344, datë 20.03.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr.1820/1, datë 02.02.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit Gjergji Pjerin Cukali, zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga ajo e “arrestit të burg” në atë të “arrestit të shtëpi”, me mbikqyrje elektronike të parashikuar nga neni 237 të P.P.Penale.

3. Më datë 20.03.2013, u bë ndalimi i shtetasit Elvis Gaçi, pasi së bashku me një person tjetër të pidentifikuar kanë vjedhur me dhunë kasafortën e Minibashkise nr.5. Më datë 02.10.2015 u bë arrestimi i këtij shtetasi për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit Kevin Rugova, i cili ngeli i vrarë, në ngjarjen e datës 01.10.2015, u gjet një sasi prej 3.3 gram lënde narkotike e llojit kokainë që i përkiste Elvis Gaçit. Më datë 08.04.2019, u bë arrestimi i këtij shtetasi, për veprën penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278 dhe 283 të Kodit Penal. Më datë 11.04.2019 Gjykata ka vendosur masën “Arrest shtëpie”. Më datë 09.10.2019 u bë arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi, në qytetin e Durrësit, për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal dhe Gjykata ka vendosur masën ‘Arrest me burg’.

4. Për shtetasit Leonard dhe Erlis Duka, me datë 28.01.2012, ka dalë urdhër ndalimi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi janë nën hetim për veprat penale të "Plagosje e lehtë me dashje", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike" dhe "Armëmbajtje pa leje", parashikuar nga nenet 274,89,278/2 të Kodit Penal. Më datë 22.11.2016 u bë ndalimi i shtetasit Leonard Duka me urdhër të Prokurorit, për të vuajtur edhe tre ditë burg të dhëna me vendim të Gjykatës Berat, për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi”, parashikuar nga neni 291 i K.Penal. Më datë 08.04.2019, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit, Leonard Duka, pasi nga kontrolli i ushtruar në banesën me qira janë gjetur 14 fishekë luftarakë, (nga kontrolli përreth pallatit, është gjetur një armë zjarri "Glock"), për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” parashikuar nga neni 278 dhe 283 të Kodit Penal. Me Vendim të shkurtuar nr.621, datë 11.04.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur masën “Arrest shtëpie”. Me vendim nr.2192, datë 27.09.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka caktuar masën e sigurimit “Arrest me burg” në mungesë për veprën penale “Vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 78-25,278/2, 28/4, 333/a të Kodit Penal. Me datë 10.11.2019, Shtetasi Erlis Duka është arrestuar për veprën penale të ‘Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve’. Në vitin 2016 vëllezërit Duka kanë tentuar të vrasin me armë zjarri shtetasin Eduart Duka. Në muajin Gusht të vitit 2019, vëllezërit Duka janë porositësit e vrasjes së shtetasit Santjago Malko.

5. Më datë 28.03.2012, në vendin e quajtur lagja "Ali Demi", gjatë një kontrolli të ushtruar nga forcat e Policisë është kapur shtetasi Eduart Dushku, i cili mbante me vehte armë zjarri pa leje. Me datë 17.03.2015, Prokuroria Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal 2594/2015, për veprën penale të “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit

Penal. Me datë 12.11.2015 është bërë pezullimi për mosgjetje të autorit të kësaj vepre penale. Në datë 04.09.2017 është kërkuar rifillimi i kësaj çështjeje penale dhe Prokuroria ka nxjerrë Urdhër Ndalimin për shtetasit Eduart Dushku. Më datë 08.09.2017 Gjykata me nr. Akti 1995, ka vendosur masën e “Arrest Shtëpie”.

Me datë 11.08.2017, u bë arrestimi i këtij shtetasi për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje” parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, pasi me datë 11.08.2017, në vendin e quajtur Sauk pas një konflikti për motive pronësie ka goditur me mjete mprehse shtetasin Skënder Osma. Më datë 14.08.2017, Gjykata vendosi me nr. Akti 1776, masën ‘Arrest Shtëpie’ për këtë shtetas. Me datë 28.02.2018, u bë arrestimi i këtij shtetasi për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, parashikuar nga nenet 278 dhe 323 të Kodit Penal. Me Vendim nr.413 datë 02.03.2018, Gjykata ka vendosur masën “Arrest me burg”, ndaj këtij shtetasi. Me datë 22.08.2011, shtetasi Eduart Dushku, ka vrarë me armë zjarri shtetasin Avdulla Vrapit, në lidhje me këtë ngjarje ai është shpallur në kërkim dhe më pas ka vuajtur dënimin me 2 vite burg

6. Shtetasi Aurel (Altin) Hoxhallari me vendim nr.408 datë 18.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është dënuar me 6 (gjashtë) muaj burgim, për veprën penale “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, arrestuar më datë 23.11.2012. Me shkurtim vendimi nr.12-2014-790(234) datë 01.06.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, ka vendodur masën e sigurimit “Arrest me burg” për veprat penale “Prodhim e mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 278/4 e 242 i Kodit Penal, arrestuar më datë 28.05.2014. Me datë 10.01.2015, është bërë ndalimi me iniciativ i shtetasit Aurel Hoxhallari, pasi dyshohet për veprat penale të ‘Vrasje në rrethana të tjera cilësuese, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim’, “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, “Krijim i grupit të strukturuar kriminal” parashikuar nga nenet 79/ë, 22,25,278/5 dhe 33/a të Kodit Penal. Me Vendim nr.269 datë 06.02.2018, ndaj personit nën hetim Aurel (Altin) Hoxhallari, i dyshuar për kryerjen e veprave penale ‘Vrasje me paramendim’ e kryer në bashkëpunim, “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 78-25,278 dhe 283/2 i Kodit Penal, caktimin e masës së sigurimit shtrëngues në mungesë të “Arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penal. Me nr.92 Akti, datë 23.04.2018, nr.92 Vendimi, datë 27.04.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, “Shkurtim Vendimi”, vijimin ndaj personit nën hetim Aurel (Altin) Hoxhallari, të masës së sigurimit “Arrest në burg”, si i dyshuar për veprën penale “Vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim, “Prodhimi dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, ‘Grupit të strukturuar kriminal’ dhe ‘Kryerjes së veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal’, të parashikuar nga nenet 78, 278/6, 283/2 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Me datë 10.01.2015, nga Sektori për Krimet e Rënda ndaj Jetës dhe Pronës, ne Drejtorinë e Policisë Tiranë, është administruar ndalimi i shtetasit Aurel Hoxhallari, dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese e rrezikshme për jetën e shumë personave e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim”, “Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake” dhe ‘Krijim të grupit të strukturuar kriminal’. Është bërë shpallja në kërkim e shtetasit Aurel Hoxhallari, me kartelë të “Kuçe”, për veprat penale “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal”, “Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim”, ‘Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake’, në lidhje me

ngjarjen e datës 29.01.2018, pasi dyshohet se ka vrarë shtetasin Devi Kasmi. Në lidhje me këtë ngjarje është bërë ndalimi me iniciativë i shtetasve: Elton Hoxholli, Efthymiou Efthymiou, Elton Halipaj, Malvin Dinellari. Në zbatim të Ekzekutimit të Urdherit të Gjyqesës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.408 datë 18.03.2011, ndaluar me datë 16.05.2014, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga nenet 242, 278 të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Kavajë, me Vendim Nr 12-2014-790(234), ka vendosur masën e sigurisë vlerësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurisë personale “Arrest me Burg”. Ndaluar më datë 10.01.2015, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga nenet 278, 333/a dhe 79-22-25, pasi më datë 05.01.2015, në vendin e quajtur rruga “Kavajës”, shtetasi Arjanit Sterio(Artur Baze) ka tentuar të vrasë me armë zjarri shtetasit Pajtim Serjani, Ditmar Reçi, Denis Ramani dhe Roland Meta, me detyrë punonjës policie. Gjatë këtij sulmi është vrarë me armë edhe personi që ka hapur zjarr viktima Arjan Sterio. Ndaluar më datë 07.01.2016 për veprën penale ‘Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik’ parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë me Urdhër Nr.175, datë 26.11.2015, mbi Vendimin Penal Nr.387/55 datë 27.03.2015, i cili ka marrë formë të prerë, me Vendimin Nr.2489, datë 23.11.2015, të Gjykatës Apelit Durrës, e cila e ka dënuar me 6 muaj burgim.

7. Shtetasi Shkëlzen Buci në bashkëpunim me shtetasin Miklar Tola, janë paguar nga shtetasi Ervin Zallumi në shumën prej 80.000 euro, për të vrarë shtetasin Mishel Prela. Me datë 21.07.2017, është bërë ndalimi i shtetasit Shkëlzen Buci, për veprat penale të ‘Vrasjes me paramendim’ e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78-22-25 të Kodit Penal, pasi shtetasi Shkëlzen Buci, dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit Mishel Prela, ngjarje e ndodhur në datë 20.07.2017, në rrugën “Tafai”, në afërsi të shkollës së mesme “Partizani”. Gjykata e Rrethit Tiranë, me shkurtim Vendimi nr.1591 akti, datë 24.07.2017, ka vendosur masën e sigurisë ‘Arrest me Burg’, për shtetasin Shkëlzen Buci. Është ndaluar më datë 21.07.2017 për veprën penale ‘Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit’, ‘Vrasja me paramendim’, parashikuar nga neni 278 dhe 78 i Kodit Penal.

8. Për shtetasin Klajdi Kodra, me vendim nr.235, datë 05.03.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është caktuar masa e sigurimit, si i dyshuar për “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/2 Kodit Penal. Me shkresë nr.19135, datë 30.12.2010, është bërë shpallja në kërkim. Me vendim nr. 548, datë 17.04.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është caktuar masa e sigurimit ‘Arrest me burg’, për veprën penale të ‘Plagosjes së lehtë me dashje’ dhe “Armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 89, 278/2 të Kodit Penal. Me shkurtim vendimi nr.2074 datë 14.08.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë masa e sigurimit ‘Arrest me burg’, për shtetasin Klajdi Kodra, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të ‘Plagosjes së lehtë me dashje’ dhe ‘Armëmbajtje pa leje’, parashikuar nga neni 89-25 dhe 278 të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr.1392, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.2074 datë 14.08.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në “Detyrim paraqitje”. Arrestuar më datë 11.08.2016 dhe lirim me datë 26.08.2016.

Me shkurtim vendimi nr.2313 datë 16.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur masa e sigurimit personal ‘Arrest në burg’, pasi dyshohet të ketë kryer veprën penale

të “Kundërshtim me dhunë të punonjësit të Policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe me shkurtim vendimi nr.565 datë 16.05.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë, shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest me burg, për shkak se ka vuajtur dënimin e dhënë me vendim nr.1350 datë 09.05.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se e ka vuajtur dënimin e dhënë me vendim nr.1201, datë 24.04.2017. Arrestur më datë 14.09.2016 liruar më datë 16.05.2017.

Me shkurtim vendimi nr.1707 datë 07.08.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë masa e sigurimit ‘Arrest me burg’, për shtetasin Kljadi Kodra, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të ‘Vrasje me dashje’ e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 76-25-22 të Kodit Penal. Me shkurtim vendimi nr.1707/1, datë 26.01.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është marrë masa e sigurimit ‘Arrest me burg’ ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurisë në ‘Detyrim paraqitje’. Arrestuar më datë 06.08.2017 dhe lirim me datë 26.01.2018.

Me datë 28.12.2009, është administruar shpallja në kërkim e shtetasit Klajdi Kodra, pasi më datë 24.12.2009, ky shtetas ka plagosur me thikë shtetasit Donald Mesinllari dhe Erald Hoxha, në rrugën “Sami Frashëri”, Tiranë, për veprën penale të ‘Vrasje me dashje të mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim’ parashikuar nga neni 76-22-25 të Kodit Penal. Me datë 07.12.2010, u ekzekutimi i udhërit të Prokurorit i datës 30.08.2010, i shpallur në kërkim më datë 28.12.2009. Arrestuar më datë 24.01.2015 për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, është kapur në flagrancë pasi posedonte një armë zjarri tip pistolette TT. Është ndaluar më datë 11.08.2016 për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, pasi në bashkëpunim me vëllain e tij më datë 03.08.2016 kanë goditur me sende të forta shtetasin Flamur Çullhaj si dhe kanë gjuajtur në ajër edhe me armë.

Është ndaluar më datë 06.08.2017 për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Vrasja me paramendim” mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 278, 78-22-25 të Kodit Penal, pasi në bashkëpunim me shtetasit Dejvis Rustemaj, Ilger Qose Dhe Liridon Rustemaj, në datë 03.08.2017 kanë qëlluar në drejtim të mjetit A777RT, duke plagosur shtetasin Mariglen Hoxha.

9.Për shtetasin Altin Barlika, me shkurtim vendimi nr.570/1 akti, datë 19.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur masa e sigurimit “Detyrim paraqitje”. Me shkurtim vendimi nr.555 regj themeltar, Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur prishjen e vendimit nr.567/6 akti, datë 28.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur ndaj shtetasit Rasim Cani masën e sigurisë ‘Detyrim paraqitje’. Në lidhje me ngjarjen e ndodhur më datë 17.03.2017, ku mbeti i plagosur rëndë dhe me pas gjeti vdekjen shtetasi Aleksandër Barlika, janë arrestuar shtetasit Altin Barlika, Klaudi Prençi, Rasim dhe Ledjan Cani. Arrestuar më datë 03.11.2014 12:00, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal. Arrestuar më datë 17.03.2017, për veprën penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 76-22-25 Kodit Penal.

10. Shtetasi Ervis Martini është arrestuar në datë 05.10.2018, për veprën penale ‘Vrasje në rrethana të tjera cilësuese’, në lidhje me vrasjen e shtetasit Fabian Gaxha, në zonën e Bllokut Tiranë. Në zbatim të Urdhër Ndalimit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë si person nën

hetim për veprat penale të ‘Plagosjes së Lehtë me dashje’ dhe ‘Prishje e rendit dhe qetësisë publike’. Shoqëruar në datë 25.02.201, si i dyshuar për “Armëmbajtje pa leje”, të gjendura në ambientet e Hotel ‘Arbëria Palace’, në Fushë Milot Kurbin. Për vrasjen në datë 11.11.2015, vrasja e shtetasit Enton Nikaj dhe plagosja e shtetasit Ismet Gaxherri, në lokal “Muraga”, Linzë Tiranë.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës:

1.Shtetasi Plaurant Dervishaj është i biri i Njaizi dhe i Liljana, i datëlindjes 02.12.1972 i lindur dhe banues në Durres, i dënuar më parë. Me vendimin penal nr.53, datë 15.03.2006 të Gjykatës për Krimet e Rënda, Tiranë është vendosur masa e sigurisë “Arrest me burg” pasi akuzohej për kryerjen e një sëri ngjarjesh të rënda pa autor të ndodhura në qytetin e Durrësit, gjatë periudhës së viteve 1997 deri në vitin 2005.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Tiranë, me vendimin penal nr.45, datë 07.07.2012 ka lenë në fuqi vendimin e dhënë, duke e dënuar shtetasin Plaurant Dervishaj me “Burgim të përjetëshëm”për veprat penale te parashikuara nga nenet 78/2 e 25 e 278/2, 76 -22 278/2, dhe 333/1 e 334/1 të Kodit Penal.

Me vendim penal nr.48, datë 27.04.2015, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ka vendosur prishjen e vendimeve të mëparshme dhe pushuar akuzat në ngarkim të shtetasit Plaurant Dervishaj.Gjykimi i kësaj çështje është me trup gjykues i përbërë nga Gjyqtar Gramoz Levanaj, Shkëlqim Miri, Genti Shala, Edmond Gogo, Aluadin Malaj.

Aktualisht me vendimin nr.115, datë 02.12.2020, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë ka vendosur masën e sigurisë “Arrest në burg” për veprën penale “Vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Mbajtje pa leje të armëve luftarake me pasoja të rënda”, “Grup i strukturuar kriminal”parashikuar nga nenet 78, 79-dh, 278/4 dhe 333/a dhe 334 të Kodit Penal. Aktualisht ky shtetas është shpallur si person në kërkim për këto vepra penale.

2.Me datë 23.02.2020 në fshatin Manzë është kontrolluar automjeti i markës “Audi” me targa AA081 TD, ku në automjet kanë qenë shtetasitRoland Farruku, i biri i Reshit dhe i Xhixhe, i datëlindjes 12.11.1977, lindur e banues në Manz, Durrës dhe shtetasiSali Hoxha, i biri i Ali dhe i Besnike, i datëlindjes 05.07.1992, banues në fshatin Manz, ku gjatë kontrollit të automjetit u gjend e sekuestrua një pistolet e markës “Berreta”

Pas kryerjes së veprimeve të para procedurale u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Roland Farruku për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe i municionit” parashikuar nga neni 278 i K.Penal si dhe arrestimi ne flagrance i shtetasit Sali Hoxha për veprën penale “Moskallëzim i krimit” parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

Me datë 27.02.2020, në seancën Gjyqësore të zhvilluar prokurori i çështjes Gezim Veizi, ka kerkuar burg me afat 1 mujor për të dy këta shtetas, ndërsa gjyqtari i çështjes Vladimir Skënderime shkurtimin e vendimit nr. 95, datë 27.02.2020 ka vendosur lirimin e shtetasit Roland Farruku dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, si dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” për të arrestuarin Sali Hoxha.

3.Me datë 07.10.2019, është bërë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit Gentjan Fadil Balla, i datëlindjes 03.12.1979, lindur në Shijak dhe banues në Xhafzotaj, i dënuar me parë për me 16

vjet burgim për veprat penale “Vrasje me dashje”, “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake” dhe “Mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë”, pasi gjatë kontrollit të bërë i është sekuestruar një armë zjarri pistolete “BROYNING PRO 40”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, ndërsa nga ana e gjyqtarit Vladimir Skënderi, me Vendim (11-2019-5636) 287, datë 10.10.2019 është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Penal, për veprat penale “Mbajtjes pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, “Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë” parashikuar nga nenet 278/2 dhe 242 K.Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka ankimuar këtë vendim (prokurore Flora Reka). Me Vendimin penal nr.2011, datë 13.11.2019, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e masës së sigurimit për shtetasin Gentian Balla, nga masa “Arrest shtëpie”, në masën e sigurimit “Arrest në burg”, ky shtetas aktualisht është person i shpallur në kërkim.

4. Me datë 04.03.2020 është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit Petrit Hasan Halili, i datëlindjes 13.12.1961, lindur dhe banues në Krujë, për veprën penale “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendim nr. 59, datë 06.03.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Arrest me burg”.

Ky shtetas është lënë i lirë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, pas vuajtjes së dënimit prej disa muajsh në I EVP Fushë – Krujë.

Me datë 11.10.2021, ky person është arrestuar përsëri për veprën penale “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” të parashikuar nga neni 231 i Kodit Penal. Me vendimin nr. 330, datë 13.10.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me gjyqtare Kostandina Kurame dhe prokuror Florian Boshnjaku kanë bërë ndryshimin e masës së sigurisë nga “Arrest në burg” duke caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”.

5. Shtetasi Lulzim Berisha, i biri Ademit dhe Rabijes i datëlindjes 13.05.1971, lindur dhe banues në Durrës, i dënuar më parë.

Me vendim nr.45, datë 02.07.2012, është vendosur lënia në fuqi të dënimit të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, duke e dënuar me “Burgim të përjetëshëm” për veprat penale të parashikuara nga nenet 333/1, 79/d, 334/1-2, 76 e 22, 278/2 Kodit penal. Me vendimin nr.48 datë 27.04.2015 të Gjykatës Apelit për Krime të Rënda Tiranë, shtetasit Lulzim Berisha i është ndyshuar masa e dënimit duke e dënuar përfundimisht me 25 vjet burgim.

Me datë 05.12.2016 me vendimin Nr.10-2016-26-59(197), Gjykata Apelit Durrës e ka liruar nga burgju shtetasit Lulzim Berisha, duke vendosur dënimin me kushte për pjesën e mbetur prej 5 vjetesh të dënimit.

Me vendimin nr.115, datë 02.12.2020, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë është vendosur masa e sigurisë “Arrest në burg” për veprën penale “Vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake me pasoja të rënda”, “Grup strukturuar kriminal” parashikuar nga nenet 78, 79-dh, 278/4 dhe 333/a dhe 334 te Kodit Penal. Aktualisht ky shtetas është shpallur si person në kërkim për këto vepra penale.

6. Shtetasi Indrit Taulla, i biri Kujtimit dhe i Hatije, i datëlindjes 11.04.1975, lindur dhe banues Durrës, me gjendje gjyqesore i dënuar më parë për vrasje.

Ky shtetas ka qënë i arrestuar dhe dënuar për veprat penale “Pjesmarrje ne organizate kriminale”, “Vrasje me paramendim”, “Rrembimi ose mbajtja peng e personit” dhe “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armeve luftarake të parashikuar nga nenet 333/2, 79/d, 109/1 e 25, dhe 278/2 e 334/1 te K.Penal.

Me datë 07.04.2006, është ekzekutuar vendimi penal nr.71, datë 29.03.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë e cila ka caktuar si mase sigurimi “Arrest ne burg” për kryerjen e disa veprave penale dhe me datë 30.07.2007, është bërë ekzekutimi i masës së sigurise për shtetasin Indrit Taullai.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.1, datë 16.01.2012, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit Indrit Taulla, për veprat penale “Pjesmarrje në organizate kriminale”, “Vrasje me paramendim”, “Rrembimi ose mbajtja peng e personit” dhe “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake të parashikuar nga nenet 333/2, 79/d, 109/1 e 25, dhe 278/2 e 334/I të K.Penal duke e dënuar me burgim të përjetshem.

Me vendimin nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë është vendosur lënia në fuqi te venimit penal nr.1, date 16.01.2012.

Me datë 29.06.2017, Gjykata për Krimet e Rënda ka vendosur pezullimin e dënimit me burgim për shtetasin Indrit Taulla, duke ndryshuar vuajtjen e dënimit nga ajo e burgut të sigurisë së lartë në shërbim prove (dënim me kusht) për shkak të gjendjes së tij shëndetsore.

Me vendimin nr.115, date 02.12.2020, Gjykata e Posaçmë e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë është vendosur masa e sigurisë “Arrest ne burg” per veprën penale “Vrasje me paramendim” e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, ”Mbajtjes pa leje te armëve luftarake me pasoja te rënda”, “Grup strukturuar kriminal” parashikuar nga nenet 78, 79-dh, 278/4 dhe 333/a dhe 334 te Kodit Penal. Me datë 15.01.2021 është bërë ekzekutimi i vendimit të Gjykatës ndaj shtetasit Indrit Taulla.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë:

1. Shtetasi Erjon Nevruz Llapushi, i datëlindjes 20.03.1988, është arrestuar me datë 30.01.2020, si i dyshuar, për kryerjen e veprës penale “Shtërëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”. Me shkurtim vendimi nr.15, datë 29.01.2019, Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda Tiranë, ka vendosur caktimin e masës së sigurisë “Arrest në burg”. Me vendimin nr.03, datë 06.01.2020, Gjykata e Posaçmë e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka shpallur moskompetencën e saj dhe ja ka dërguar çështjen, për gjykim, Gjykatës së Apelit Korçë. Me shkurtim vendimi Nr.25, datë 10.03.2020, kjo gjykatë ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” dhe ka urdhëruar lirimim e menjëhershëm të tij.

Ky shtetas rezulton përsëritës, për vepra të rënda penale, që tregojnë rrezikshmërinë e autorit dhe aktualisht, në datën 02.10.2021, është shpallur në kërkim nga DVP Elbasan, si i dyshuar për kryerjen e vepres penale "Plagosja e rëndë me dashje" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 88-25 të K.Penal (ngjarje ku mbeti i vdekur kamarjeri i restorantit “Rozafa”).

2. Shtetasi Gaqo Koço Peci, i datëlindjes 28.09.1984, është referuar në Prokurori, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78/2 e 22 të K.Penal. Me vendimin Nr.169, datë 23.06.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg” dhe me kërkesë të Prokurorit Juljan Kristo, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin Nr.40, datë 05.02.2020, ka vendosur

zëvendësimin e masës së sigurimit në “Detyrim paraqitje” para Oficerit të Policisë Gjyqësore, hetimet kanë përfunduar dhe çështja vijon të jetë në gjykim.

3. Shtetasi Gerd Stefan Gjinarari alias Gerti Gjenerali, i datëlindjes 14.05.1974, i dënua me “Burgim të përjetshëm”, për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78-25 të K.Penal. Ky shtetas ka qenë duke vuajtur dënimin, pranë IEVP Korçë dhe është liruar me kusht, me vendimin Nr.1/54DA, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të gjyqtarit Markelian Kuqo.

Aktualisht ky shtetas është shpallur në kërkim, nga DVP Korçë, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka dërguar urdhrin e datës 26.06.2019, për ekzekutimin e vendimit Nr.79, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit Nr.1/54DA, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, me objekt “Lirim me kusht”.

4. Me datë 25.02.2020, është arrestuar në flagrancë shtetasi Agjerim Sherif Hysen, i datëlindjes 14.01.1998, për veprën penale “Plagosja e lehtë” me dashje e kryer në bashkëpunim.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me prokuror të çështjes Odeta Todorusha, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”. Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, me gjyqtar Markelian Kuqo, me vendimin nr.62, datë 28.02.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Detyrim paraqitje” për këtë shtetas.

5. Me datë 21.08.2020, është arrestuar shtetasi Erzen Zarif Qeva, i datëlindjes 18.08.1972, për veprën penale “Vetëgjyqësia” parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me prokuror të çështjes Shkëlqim Kokona, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest shtëpie”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me gjyqtar Artan Jahollari, me vendimin nr.187, datë 24.08.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Detyrim paraqitje” për këtë shtetas.

6. Medatë 21.08.2020, është arrestuar në flagrancë shtetasi Gëzim Nazmi Memelli, i datëlindjes 23.04.1952, për veprën penale “Shtrengim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me prokuror të çështjes Shkëlqim Kokona ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest shtëpie”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me gjyqtar Artan Jahollari, me vendimin nr.188, datë 24.08.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Garanci pasurore” me vlerë 300.000 lekë për këtë shtetas.

7. Me datë 23.10.2020, është arrestuar në flagrancë shtetasi Enver Hekuran Polisi, i datëlindjes 16.03.1963, për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “Prishja e qetësisë publike” parashikuar nga nenet 236/2 dhe 274 të Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me prokuror të çështjes Shkëlqim Kokona, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me gjyqtar Shkëlqim Kokona, me vendimin nr.267, datë 26.09.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Arrest shtëpie” për këtë person.

8. Me datë 15.11.2020, është arrestuar në flagrancë shtetasi Destan Sami Oparaku, i datëlindjes 28.04.1987, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me prokuror të çështjes Shkëlqim Kokona, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me gjyqtar Artan Jahollari, me vendimin nr.300, datë 18.11.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Arrest shtëpie” për këtë person.

9. Me datën 15.11.2020, është arrestuar në flagrancë shtetasi Valenti Zydi Llënga, i datëlindjes 20.08.1988, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me prokuror të çështjes Shkëlqim Kokona, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me gjyqtar Artan Jahollari, me vendimin nr.300, datë 18.11.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Arrest shtëpie” për këtë person.

10. Me datë 13.12.2020, është arrestuar në flagrancë shtetasi Simon Agron Jesku, i datëlindjes 19.11.1981, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar nga nenet 150 dhe 236/2 të Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, me prokurore të çështjes Dorina Bejko, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg 40 ditë”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me gjyqtar Artan Jahollari, me vendimin nr.335, datë 16.12.2020 ka vendosur masën e sigurisë “Arrest shtëpie” për këtë person.

11. Me datë 08.08.2021, është arrestuar në flagrancë shtetasin Eljon Neki Koçibelli, i datëlindjes 01.03.1979, për veprën penale “Ngacmimi seksual” parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me prokurore të çështjes Oli Visi, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me gjyqtar Ervin Sulaj, me vendimin nr.249, datë 11.08.2021 ka vendosur masën e sigurisë “Arrest shtëpie” për këtë person.

12. Me datë 23.08.2021, është arrestuar në flagrancë shtetasin Anri Arben Reli, i datëlindjes 08.11.1994, për veprat penale “Plagosja e rëndë me dashje” dhe “Kanosja” parashikuar nga nenet 88 dhe 84 të Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, me prokuror të çështjes Olger Eminaj, ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest në burg”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me gjyqtar Selajdin Pysqyli, me vendimin nr.266, datë 27.08.2021, ka vendosur masën e sigurisë “Arrest shtëpie” për këtë person.

Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë:

1.Shtetasi Risi (Kreshnik) Hasan Lika, i datëlindjes 24.07.1986, lindur dhe banues ne fshatin Malbardhe, Kurbin

Me vendimin nr. 118, datë 04.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka caktuar masën mjekësore shtrim në spital me afat 1 muaj. Personi është shumë problematik dhe agresiv, me problem të shëndetit, gjyqtar Olti Skrame.

2. Shtetasi Xhan Xhaferr Kaci, i datëlindjes 14.01.1986, lindur dhe banues në fshatin Droje, njesia administrative Mamurras, bashkia Kurbin.

Ky person është arrestuar për veprat penale “Kultivim i bimëve narkotike” dhe “Armëmbajtje pa leje”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin me Vendimin nr.56, datë 24.06.2021 ka caktuar masën e sigurisë “Arrest burg”, ndërsa Gjykata e Apelit Tirane me gjyqtare Elbana Lluri me vendim nr. 646, datë 28.07.2021, ka ndryshuar masën e sigurisë nga “Arrest burg” në “Arrest shtëpie”.

3. Shtetasi Daniel Rrok Gjeloşi, i datëlindjes 20.06.1998, lindur dhe banues në fshatin Fushë Kuqe, Kurbin.

Ky person është arrestuar për veprat penale “Armëmbajtje pa leje” dhe “Kanosje me armë” me vendim nr.82, datë 28.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka caktuar masën e sigurisë “Arrest burg”, ndërsa Gjykata e Apelit Tirane me gjyqtare Elbana Lluri me vendim nr. 779 datë 01.09.2021, ka ndryshuar masën e sigurisë nga “Arrest burg”, në “Arrest shtëpie”.

4. Shtetasi Aleks (Fatjon) Dalipi (Lika), i datëlindjes 27.03.1990, lindur dhe banues në fshatin Malbardhe të bashkisë Kurbin, i dënuar disa here, i arrestuar për veprat penale “Kundërshtim të punonjësit të Policisë të Rendit Publik”, “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt” dhe “Armëmbajtje pa leje të armëve sportive dhe gjuetise”. Gjykata Rrethit Gjyqësor Kurbin me Vendim nr.1059, datë 30.07.2021, ka caktuar masën e sigurisë “Arrest burg”, ndërsa Gjykata e Apelit Tirane me gjyqtare Elbana Lluri me vendim nr. 796, datë 01.09.2021 ka ndryshuar masën e sigurisë nga “Arrest burg” në “Arrest shtëpie”.

5. Më datë 02.07.2021, është arrestuar në flagrancë shtetasi Ylli Sherif Dungaj, i datëlindjes 12.06.1970, banues në Lagjen “Skënderbeg”, Lezhë.

Ky person për motive të dobëta ka plagosur rëndë një shtetas. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me datë 07.09.2021 me gjyqtar Ilir Përdedaj ka vendosur masën “Detyrim paraqitje”.

6. Shtetasi Aldi Rufan Rama, i datëlindjes 04.09.1991, i cili është arrestuar më 29.07.2018, ka qenë i dënuar me 3 vite e 4 muaj burg për “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, me Vendim nr 53-2019-708, datë 04.03.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë. Po kështu me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë Nr 53-202-1887, datë 22.10.2020, i është dhënë masa e sigurisë “Arrest me burg” për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike” dhe me Vendim nr 303, datë 06.05.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka vendosur konstatimin e shuarjes së masës së sigurisë arrest me burg dhe caktimin e masës së sigurisë “Arrest në shtëpi”, kjo pasi çështja është dërguar për gjykim dhe prokurori Françesk Ganaj ka kërkuar gjykimin e çështjes dhe konstatimin e shuarjes së masës së sigurisë “Arrest me burg” duke kërkuar arrest në shtëpi, vendimi është marrë nga gjyqtari Artan Hajredinaj. Me datë 28.09.2021, ky person ka vrarë punonjësin e policisë Saimir Hoxha.

7. Më datë 19.12.2020, është bërë ndalimi me iniciativë të shtetasit Nikoll Luigj Sherniku, i datëlindjes 05.12.1994, banues në Fushkuqe, Kurbin, Lezhë, pasi dyshohet për vrasjen në

bashkëpunim të punonjesit të policisë Xhulio Prela, ngjarje e ndodhur me datë 05.12.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me datë 27.10.2021, me gjyqtar Ilir Perdetë, pasi ka pranuar kërkesën e personit nën hetim ka ndryshuar masën e sigurisë nga “Arrest burg” në “Arrest shtëpie”.

8. Shtetasi Maringlen Kadri Medja, i datëlindjes 16.01.1991, banues në Lezhë, i dënuar disa herë për “Vjedhje”, “Mosbindje ndaj urdhërave të punonjësve të policisë” dhe “Dhunë në familje”. Ky person me vendim të gjyqtarit Jak Ndoka është liruar më datë 21.01.2021, me kërkesë të dënuarit dhe është shpallur përsëri në kërkim më datë 08.11.2021 për veprën penale “Dhunë në familje”.

9. Më datë 26.10.2009, në qytetin e Rreshenit-Mirditë, shtetasi Tonin Ndoj (aktualisht në burg), në bashkëpunim me shtetasit Arjan Prenga dhe Amarildo Zef Ndoj, i datëlindjes 12.01.1991, banues në Rreshen-Mirditë, kanë vrarë me armë zjarri për motive të dobëta shtetasin Edison Jaku. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin Nr.15, datë 24.01.2011, e ka dënuar shtetasin Amarildo Ndoj, me 14 vjet burgim, për veprat penale të parashikuara nga nenet 78-25 dhe 278 të Kodit Penal. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin Nr.239, datë 07.11.2011, e ka dënuar shtetasin Amarildo Ndoj, me 4 vjet burgim, ku me datë 18.10.2012, ky shtetas është larguar nga IEVP-Shënkoll.Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr.128, datë 30.04.2014, e ka dënuar shtetasin Amarildo Ndoj, me 12 vjet burgim, ku i ka zbritur dënimi i vuajtur dhe ka për të vuajtur edhe 8 vjet burgim.

Ky person me datë 26.11.2016, në vëndin e quajtur Kodër Rreshen, ka kanosur me armë zjarri shtetasin Nikoll Preçi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.164, datë 27.09.2017, e ka dënuar me 5 vjet dhe 6 muaj burg, për veprat penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe ‘kanosje’, parashikuar nga nenet 278/1 dhe 84 të Kodit Penal.

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër:

1. Me datë 21.03.1999, shtetasit Behar Muhamet Rustemi(Bajri), Bardhyl Jonuz Rustemi(Bajri) dhe Arben Xhavit Tuzi, janë plagosur me armë zjarri si pasoje e një grindje. Fillimisht shtetasit Behar e Bardhyl Rustemi janë akuzuar për veprën penale “vrasje e mbetur në tentative”, por kjo çështje është pushuar. Shtetasit Behar Muhamet Rustemi(Bajri), Bardhyl Jonuz Rustemi(Bajri) dhe Arben Xhavit Tuzi, ka qënë të pandehur për veprën penale “Armmbajtje pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 K.Penal.

Këta persona janë dënuar respektivisht, Behar Rustemi me 9 muaj e tre ditë, Bardhyl Rustemi me 8 muaj e 21 ditë burgim, Arben Tuzi me 1 muaj burgim, për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 K.Penal.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 97 date 03.03.2020, me trup gjykues: Lindita Hoxha, Kastriot Gramshi, Enkeledi Bicakani, dhe Prokuror Lazer Cardaku.

2. Shtetasi Astmer Astrit Bilali është arrestuar në flagrancë me datë 28.01.2014, pasi në banesën e tij janë gjetur e sekuestruar dy armë zjarri automatike mod-56. Me datë 30.01.2014 për këtë shtetas Gjykata ka dhënë masën e sigurisë personale “Arrest në burg”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 147, datë 26.02.2014, i ka ndryshuar masën e sigurimit nga arrest në burg në “Detyrim paraqitje”. Duke qënë me masën e sigurimit në fjalë,

me datë 14.04.2014, është shpallur në kërkim për veprat penale të “Goditje për shkak të detyrës”, “Kanosje” dhe “Prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake e municioneve”, Për ngjarjet e mësipërme është arrestuar me datë 16.06.2014 dhe është liruar me datë 07.01.2015 pasi në vendimin nr. 01 të Gjykatës së Rrethit Shkodër është gjetur fajtor por dënuar 3 vjet me kusht. Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkoder, vendimi nr. 51 date 15.09.2014, të gjyqtarit Erjon Bani dhe prokuror Federik Laloshi.

3. Me datë 07.06.2016 shtetasi Astmer Astrit Bilali në bashkëpunim me shtetasit Endri Mustafa, Ardit Torishta, Bekim Torishta, Senad Balani, kanë plagosur shtetasit Emiljan Gjergji dhe Gasper Marku, si dhe i kanë kanosur me armë ata. Materjalet janë referuar për veprat penale “Armëmbajtje pa leje”, “Kanosja” dhe “Plagosje e lehte” me dashje në bashkëpunim.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtare Luveda Dardha dhe Prokuror Astrit Halilaj, me vendimi nr. 354, datë 03.05.2017, e ka dënuar shtetasin Astmer Bilali me 8 muaj burg vetem për veprën penale të armëmbajtjes pa leje parashikuar nga neni 278/2 ndërsa akuzat e tjera janë pushuar.

4. Me datë 03.08.2017, shtetasi Orlando Planaj ka shkuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, ku ka fyer, kundërshtuar me dhunë dhe kanosur punonjësit e policisë së patrullës së përgjithshme. Materjalet janë referuar për veprat penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë” dhe “Kanosje për shkak të detyrës”.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër, me trup gjykues Tonin Sterkaj dhe prokuror Lazer Çardaku, me vendimin nr. 229 date 05.02.2019, e ka dënuar me 6 muaj burgim por i është ulur 1/3 dhe dënimi mbetur i është kthyer në dënim me kusht.

5. Me datë 27.07.2001, shtetasit Asllan Cafi, Bledar Cafi, Gani Bukrina(Cafi), në lagjen “Lirija”, Shkodër kanë vrarë me armë zjarri në banesën e tij shtetasin Shyqyri Mustafa. Materjalet janë referuar për veprat penale “Vrasje me paramendim” në bashkëpunim dhe “Armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 78/1 e 25, 278/2 te K.Penal.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkoder, me trup gjykues Ken Dhima, Hasan Selimi, Albano Çepele dhe prokuror Përparim Kulluri, me vendimin nr. 461 date 23.11.2009, e ka dënuar Asllan Cafi me 5 vite burgim për “Vrasje në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme” dhe “Armëmbajtje pa leje” parashikuar nga nenet 83 dhe 278/2 te K.Penal, shtetasi Bledar Cafi është gjetur i pafajshëm, shtetasi Gani Bukrina është dënuar me 2 vjet burgim për veprat penale të “Kanosjes” dhe “Armëmbajtjes pa leje” parashikuar nga nenet 84 dhe 278/2 te K.Penal.

6. Me datë 28.01.2000 në fshatin Dobraq, Shkodër, shtetasi Behar Bajri ka vrarë me armë zjarri për motive të dobeta shtetasit Petrit Demiraj. Materjalet janë referuar për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Armëmbajtje pa leje” parashikuar nenet 76, 278/2, 25, të K.Penal.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër, me trupi gjykues Arben Zefi, Kastriot Gramshi, Tonin Sterkaj, me prokuror Pjeter Ujka, me vendimin nr. 103 date 20.04.2001, e ka dënuar për veprën penale të “Vrasjes në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme” duke e dënuar me 2 vite e 6 muaj burgim dhe për “Armëmbajtje pa leje” me 3 muaj burg.

7. Me datë 01.11.2003, është kapur me armë zjarri pistolete pa leje, shtetasi Behar Muhamet Bajri (Rrustemi). Materjalet janë referuar për veprat penale “Armembajtje pa leje” me shumë se një here, neni 278/4, te K.Penal.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër, me trup gjykues Arben Zefi, Maliq Memcaj, Tonin Sterkaj me prokuror Pllumb Premci, me vendimin nr. 199, datë 13.07.2004, ku është kërkuar nga prokuroria 5 vite burgim por është dënuar me 1 vit e 4 muaj burgim.

8. Shtetasi Behar Muhamet Bajri (Rrustemi) është kapur me armë zjarri pistolete pa leje. Materjalet janë referuar për veprat penale “Armembajtje pa leje”, parashikuar nga neni 278/2, te K.Penal.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkodër, me trup gjykues Tonin Sterkaj dhe prokuror Përparim Vukaj, me vendimin nr. 1 date 08.01.2003, është dënuar me 7 muaj burgim dhe në zbritje me 1/3 të dënimit është dënuar me 4 muaj e 20 dite burgim.

9. Shtetasi Ilir Nulo Bajri (Rrustemi) është akuzuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” dhe “Armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 88/1, 278/2, te K.Penal.

Gjykata Rrethit Gjyqësor Shkoder, me trup gjykues Tonin Sterkaj, Genti Shala, Gasper Elezaj dhe prokuror Ilir Golemi, me vendimin nr. 56 date 28.04.1999, është shpallur i pafajshëm pasi prokuroria ka kërkuar pushimin e çështjes.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier:

1. Me datë 12.08.2020, është ndaluar shtetasit Musa Bujar Gudo, i datëlindjes 18.04.1994, banues në Portez, Fier dhe i shtetasit Orgest Ali Alicani, i datëlindjes 12.07.1995, banues në Portëz, Fier, për veprën penale “Shtrengimit me anë të kanosjes ose me dhunë për dhënie pasurie”, të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal.

Me Vendim Nr.445 date 23.12.2020 te Gjykatës se Rrethit Fier është dënuar me 1 vit e 8 muaj burg, për veprën penale “Shtrengimit me anë të kanosjes ose me dhunë për dhënie pasurie” Gjyqtari Taulant Banushi.Kohëzgjatja e vuatjes së dënimit nga data 12.05.2020 (arrestuar) deri në datën 05.07.2021(liruar). Shtetasi Orges Ali Alicani është dënuar për veprën penale “Moskallzim krimi” duke e dënuar me 120.000(një qind e njëzet mijë)leke gjobë.

2. Me datë 07.09.2021, është ndaluar shtetasi Erjon Hysen Agalliu, i datëlindjes 20.06.1979, banues në Fier dhe shtetasi Arben Ramadan Bleta, i datëlindjes 30.04.1967, banues në Fier, për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” parashikuar nga neni 110 i kodit penal.

Me Vendim 62-2021-4233(1140), vlefesimin si të ligjshëm ndalimin, dhe caktimin e masës së sigurimit personal ndaj ketyre shtetasve “Detyrimi për tu paraqitur në policinë gjyqsore”, nga gjyqtar Olkeda Lice.

3. Shtetasi Florian Petro Vasuu, datëlindjes 21.07.1987, lindur e banues ne Fier është shpallur në kërkim më datë 18.05.2006 për veprën penale "Heqje paligjshme lirisë" pasi është dënuar me 4 vjet burgim. Me Vendim nr.265, datë 06.12.2006 të Gjykatës Shkallës së Parë Fier lënë në fuqi me Vendim Nr.229, datë 10.07.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Me vendim nr. 615, datë 19.09.2012 Gjykata Shkallës së Parë Fier ka bërë shuarjen e dënimit.

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan:

1. Shtetasi Migen Ismet Kaçkini , dyshuar për veprën penale “Dhunë në familje “. Arrestuar më datë 24.08.2020, liruar më datë 29.01.2021 . Masa e sigurisë e dhënë: “Arrest në shtëpi“.

2. Shtetasi Ervis Enver Muça , dyshuar për veprën penale “Dhunë në familje “. Arrestuar më datë 19.02.2021, liruar më datë 17.04.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “Detyrim paraqitje“.

3. Shtetasi Çlirim Qemal Zekthi, dyshuar për veprën penale “ Plagosje e rëndë me dashje “. Arrestuar më datë 13.01.2021, liruar më datë 09.07.2021 . Masa e sigurisë e dhënë: “Detyrim paraqitje“.

4. Shtetasi Redon Astrit Kurti, dyshuar për veprën penale “Marrëdhënie seksuale me të mitur “Arrestuar më datë 05.06.2021, liruar më datë 03.07.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “Detyrim paraqitje“.

5. Shtetasi Marsel Xheladin Jevgu, dyshuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje “. Arrestuar më datë 01.06.2021, liruar më datë 30.06.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “ Detyrim paraqitje“.

6. Shtetasi Feliks Faik Filja, dyshuar për veprën penale “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë, prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve“. Arrestuar më datë 25.10.2020 , liruar më datë 12.05.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “ Detyrim paraqitje “.

7. Shtetasi Gazmor Riza Trimi, dyshuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje“. Arrestuar më datë 01.10.2021, liruar më datë 13.10.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “Detyrim paraqitje“.

8. Shtetasi Arnold Avni Beqiri, dyshuar për veprën penale “Dhunë në familje“. Arrestuar më datë 01.09.2021, liruar më datë 22.09.2021. Masa e s sigurisë e dhënë: “Arrest në shtëpi“.

9. Shtetasi Jetnor Flori Allkja, dyshuar për veprën penale “Dhunë në familje“. Arrestuar më datë 05.07.2021, liruar më datë 26.07.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “ Detyrim paraqitje“.

10. Shtetasi Gjoni Qemal Karaj, dyshuar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje “. Arrestuar më datë 15.05.2021, liruar më datë 02.06.2021. Masa e sigurisë e dhënë: “ Detyrim paraqitje“.

Gjithashtu, Ju informojmë se, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në disa raste kur, persona për të cilat është marrë masa shtrënguese “Arrest në flagrancë” dhe janë liruar nga Prokuroria/Gjykata , i ka dërguar informacion Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Brendshme, konkretisht për rastet e poshtëshënuara:

1. Më datë 03.03.2021, në lagjen "Bashkimi" Vlorë është vrarë me armë zjarri shtetasi Tauland Gjikalj, alias Beqiraj, alias Manaj, i biri i Astrit dhe i Feride, i datëlindjes 13.01.1990, lindur dhe

banues në Vlorë. Për këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka regjistruar procedimin penal Nr. 292 të vitit 2021.

Nga kryerja e veprimeve të para procedurale u identifikua njëri nga autorët e kryerjes së kësaj vepre penale, i cili është shtetasi Hansi Jonuzi, i biri i Mentor dhe i Lala, i datëlindjes 18.09.1977, lindur dhe banues në lagjen "29 Nëntori" Vlorë, me numër personal H70918062F. Ky person ishte drejtues i autoveturës Ford Focus, me targa AA403PX, të përdorur nga autorët për kryerjen e vrasjes, mjet në të cilin në pjesën e pasme u gjet dhe u sekuestrua me cilësinë e provës materiale edhe një armë zjarri automatik model "Kallashnikov model 56", së bashku me krehërin dhe 30 (tridhjetë) fishekë, ndaj të cilit u mor masa e arrestimit në flagrancë për veprat penale "Vrasja me paramendim" kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", parashikuar nga nenet 78, 25 dhe 278 i K. Penal.

Nga kryerja e veprimeve të tjera procedurale u dokumentua fakti se, ekzekutor i vrasjes së shtetasit Tauland Gjika, është shtetasi Elton Hajnaj, i biri i Lulzim dhe i Tefta, i datëlindjes 05.11.1977, lindur dhe banues në lagjen "29 Nëntori" Vlorë, të cilën e ka kryer në bashkëpunim me shtetasit Hansi Jonuzi dhe shtetasin Skedjan Gabrani, i biri i Izet dhe i Gjenovefa, i datëlindjes 05.06.1985, lindur dhe banues në lagjen "Osman Haxhiu" Vlorë. Pas vrasjes të tre autorët janë larguar me automjetin Ford Focus, me targa AA 403 PX. Gjatë largimit në drejtim të automjetit Ford Focus është qëlluar me armë zjarri nga shtetasi Sali Zeneli (Hoxhaj), i biri Agim dhe i Valentina, i datëlindjes 11.01.1990, lindur dhe banues në Panaja, Vlorë, i cili ka qenë së bashku me viktimën.

Në vijim të veprimeve procedurale ndaj autorëve të ngjarjes janë caktuar dhe masat e sigurisë si më poshtë;

- ✓ Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë me vendimin Nr 62, datë 06.03.2021, ka caktuar masën e sigurimit "Arrest me Burg", për shtetasin e arrestuar Hansi Jonuzi.
- ✓ Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin Nr. 73, datë 15.03.2021, ka caktuar masën e sigurimit "Arrest me Burg" në mungesë për shtetasit Elton Hajnaj dhe Skedjan Gabrani, për veprat penale "Vrasja me paramendim" kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit", parashikuar nga nenet 78, 25 dhe 278 i K. Penal.
- ✓ Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin Nr. 73, datë 15.03.2021, ka caktuar masën e sigurimit "Arrest me Burg" në mungesë për shtetasin Sali Zeneli për veprat penale "Vrasje me dashje", mbetur në tentativë dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve luftarake dhe i municionit", parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 278/1 të K. Penal.

Me datë 20.05.2021, u vetëdorëzua shtetasi në kërkim Skedjan Gabrani dhe është ekzekutuar masa e sigurisë ndaj tij, ndërsa shtetasit Elton Hajnaj dhe Sali Zeneli janë ende në kërkim.

Me shkresën Nr. 11188/1 Prot, datë 29.09.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka dërguar urdhrin për ekzekutimin e menjëhershëm të Vendimit Nr.309, datë 29.09.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit nga "Arrest në burg" në "Arrest në shtëpi" për personin nën hetim Hansi Jonuzi. Më datë 29.09.2021 nga ana e policisë gjyqësore është bërë ekzekutimi i vendimit penal dhe aktualisht personi nën hetim Hansi Jonuzi është në masën e sigurimit "Arrest në shtëpi".

2.Me datën 14.06.2021, në orën 19:55 me mbeshtetjen e forcave speciale "RENEA", u ushtrua kontroll në lokalin "Grand Gelato", në lagjen Uji Ftoftë, në Kompleksin Oslo, lokal në pronësi të shtetasit Edison Begaj, person me precedent penal dhe në ambientet e jashtme të këtij lokali

gjatë kontrollit fizik të shtetasit Edison Arkimet Begaj, i datëlindjes 17.03.1980, lindur dhe banues në fshatin Kaninë Vlorë, me numer personal 100317103R, në çantën e tij (marsup) u gjet dhe u sekuestrova me cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistolete, model 54, e kalibrit 7.62mm, së bashku me krehërin e saj me 5(pesë) fishekë luftarake, model 54, të kalibrit 7.62mm, që mbaheshin pa leje nga ana e tij. Materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjyktës së Shkallës së Parë Vlorë për nenin 278 të K.Penal.

Me vendimin Nr. 159, datë 18.06.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ndër të tjera është vendosur:

- ✓ Vlerësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë në datën 14.06.2021 ndaj personit nën hetim Edison Arkimet Begaj, i dyshuar për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municioneve” të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal.
- ✓ Caktimin ndaj personit nën hetim Edison Begaj të masës së sigurimit personal shtrëngues atë të “arrestit në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe urdhërimin për lirim të menjëhershëm nëse nuk ka vendim tjetër dënimi me burgim apo vendim tjetër për caktimin mase sigurimi të parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

Në vendimin e shkurtuar të Gjykatës theksohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë me përfaqësuese prokuroren Elona Alvora, ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të arrestit të bërë nga policia gjyqësore, caktimin e masës “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.

3.Me datën 02.06.2021, ora 20.00, është arrestuar në flagrancë shtetasi Hektor Gjovalin Ndreu, i datëlindjes 02.08.1982, banues në lagjen “Tre Heronjtë”, Shkodër, me arsim 8 klasë, pasi në ora 17.30, në lagjen “Tre Heronjtë”, në Rrugën “Revolucioni Austro Hungarez”, pas një kontrolli të ushtruar ndaj tij dhe mjetit me të cilin po udhëtonte nga shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, e konkretisht njësia “Shqiponja”, ju gjet e bllokua në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit tip pistoletë “TT”, me Nr.9675693 66 1964, një krehër me 6 fishekë dhe një fishek në fole që mbaheshin pa leje nga ana e tij.

Materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjyktës së Shkallës së Parë Shkodër për nenet 278 e 301 të K.Penal, me Nr. Unik 202106020588.

Me vendimin Nr. 286, datë 05.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ndër të tjera është vendosur:

- ✓ Vlerësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë në datën 02.06.2021 ndaj personit nën hetim Hektor Gjovalin Ndreu, i dyshuar për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municioneve” të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal.
- ✓ Caktimin ndaj personit nën hetim Hektor Ndreu të masës së sigurimit personal shtrëngues atë të “arrestit në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe pranimin e zëvendësimit të saj me masën e garancisë pasurore në zbatim të nenit 236, pika “2” e K.Pr.Penale, deri në përfundim të procedimit penal ndaj këtij personi, duke përcaktuar si garanci pasurore shumën prej 500.000 Lekë.
- ✓ Masa e arrestit në shtëpi qëndron në fuqi deri në momentin e depozitimit të shumës së përcaktuar nga gjykata në zbatim të masës së sigurimit “Garanci pasurore” e parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale.

Në vendimin e shkurtuar të Gjykatës theksohet se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër me përfaqësuese prokuroren Edlira Cufi, ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të arrestit të bërë nga

policia gjyqësore, caktimin e masës “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale dhe “garanci pasurore” në shumën 500.000 Lekë, parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale.

4.Më datë 15.06.2021, në orën 20:00, me mbështetjen e forcave speciale të repartit “RENEA”, Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka ushtruar kontroll në lokalit “Grand Petrol” në fshatin “Fermë Çlirim” të qytetit të Fierit, e konkretisht në lokalit e shtetasit Kujtim Kuçi, person me precedent penal. Në momentin që forcat speciale “RENEA” u futën në ambientet e lokalit, dy persona u larguan me vrap duke kapërcyer murin rrethues të lokalit, ku njëri prej tyre hodhi një çantë marsup në një grumbull shkurresh në pjesën e pasme të lokalit. Forcat speciale “RENEA” neutralizuan shtetasit Indrit Hajris Kuçi(Hoxhaj) i cili hodhi çantën, dhe shtetasin Sajmir Seit Aliaj(Kuçi), të dy banues në “Fermë Çlirim”.

Nga kontrolli u gjet dhe u sekuestrua një çantë brenda të cilës kishte një armë zjarri tip pistoletë model 57, kalibër 7.62mm, e cila ishte me krehër të vendosur në vendin e saj me 9(nëntë) fishekë si dhe një krehër rezervë me 7(shtatë) fishekë brenda tij. Gjithashtu në çantë u gjetën dy karta identiteti të shtetasit Indrit Hajriz Kuçi(Hoxhaj), i datëlindjes 05.11.1994.

Në përfundim të veprimeve hetimore, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Indrit Kuçi(Hoxhaj), i biri i Hajri dhe Tatjana, i datëlindjes 05.11.1994, lindur dhe banues në “Fermë Çlirim”, Fier, për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë e municioneve”, parashikuar nga neni 278/1/2 i K.Penal.

Me datë 17.06.2021, Gjykata e Shkallës së Parë Fier, pasi shqyrtoi kërkesën penale me palë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier e përfaqësuar nga prokurori Erind Reovica, i cili ka kërkuar për personin nën hetim Indrit Kuçi(Hoxhaj) si masë sigurimi atë të “Arrestit në shtëpi”, me Vendim (i përmbledhur), vlerësoi të ligjshëm arrestimin në flagrancë të personit nën hetim Indrit Kuçi(Hoxhaj), duke caktuar si masë sigurimi atë të “Arrestit në shtëpi”.

Theksojmë se shtetasi Indrit Kuçi(Hoxhaj) është i evidentuar si person me precedentë penalë, dhe për këtë shtetas Gjykata e Apelit Vlorë me vendim nr. 236, datë 08.07.2014, ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg” për veprën penale “Vrasje në mënyrë të rrezikshme për jetën e disa personave” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/e, 25-22 të K.Penal. Për këtë veprë penale Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me Vendimin nr. 630, datë 20.07.2015, ka vendosur shuarjen e masës së sigurisë “Arrest në burg” dhe vendosjen e masës së sigurisë “Detyrim për paraqitje” para oficerit të policisë gjyqësore.

5.Nisur nga ngjarja e rëndë e ndodhur në fshatin Zhupan, Fier, më datë 11.09.2021, ku shtetasi Elton Bashkim Bengaj (Meta) i datëlindjes 10.09.1989 ka vrrarë me armë zjarri ish-bashkëshorten e tij Sabina Bengaj, me shkresë nr. 6593/1, datë 14.10.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i ka dërguar informacion Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, pasi konkludohet se kjo ngjarje e rëndësishme pasojë edhe e vendimeve jo korrekte të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.

Me vendimin nr.181 datë 01.03.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur:

Caktimin e masës së sigurisë “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, parashikuar nga neni 46/2 i Kodit Penal

Pushimin e çështjes nr.1020 date 21.09.2020, ndaj personit nën hetim Elton Bengaj (Meta), për veprat penale “Dhunë në familje”, “Kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, “Mbajtje pa leje

e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” të parashikuar nga nenet 130/a/2; 236/2; 278/1 të Kodit Penal.

Me shkurtim të vendimit, të datës 26.07.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur:

Zëvendësimin e masës së sigurisë nga “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, të parashikuar nga neni 46/2 të Kodit Penal, të caktuar me vendimin nr.181 datë 01.03.2021 të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Fier, në masën mjekësore “Mjekim i detyruar ambulator” nën kujdesin e babait të tij shtetasit Bashkim Meta dhe urdhërohej shtetasi Elton Bengaj (Meta) të paraqitet 1 herë në muaj pranë mjekut neuro-psikiatër në Poliklinikën e Specialiteteve Fier.

Për ekzekutimin e këtij vendimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka lëshuar urdhër ekzekutimi, dërguar me shkresën nr.6856 Prot. D.T datë 26.07.2021, Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Krujë, ku urdhrohet ekzekutimi i vendimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ndërkohë që shtetasi Elton Bengaj (Meta) vuante dënimin, në Burgun e Zaharisë Krujë, më datë 13.07.2021, është paraqitur në Komisaratin e Policisë Fier, ish-bashkëshortja e tij, shtetasja Sabina Bengaj, e cila ka kallzuar se, ish-bashkëshorti e kërcënonte nëpërmjet telefonit. Nga ana e Komisarimit të Policisë Fier, janë referuar materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, në ngarkim të shtetasit Elton Bengaj, përveprënpenele“Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”,tëparashikuarnganeni 321/1 i Kodit Penal.

Më datë 26.07.2021 shtetasi Elton Bengaj është liruar me masën: “Mjekim ambulator”.

Duke Ju falënderuar për vëmendjen,,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Drejtues Madhor Gledis NANO